VENDIM
Nr. 12, datë 23.1.2020

MBI DISA NDRYSHIME NË KONTRATËN E SHITBLERJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE MES SHOQËRISË SË NGARKUAR ME DETYRIMIN E SHËRBIMIT PUBLIK PËR BLERJEN E ENERGJISË ELEKTRIKE TË PRODHUAR NGA PRODHUESIT ME PËRPARËSI

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 20, germa "h", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, VKM-së nr. 883, datë 27.12.2019, "Mbi disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 244, datë 30.3.2016, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike", të ndryshuar, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 23.1.2020, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë së Çështjeve Ligjore, nr. 14/1 prot., datë 15.1.2020, në lidhje disa ndryshime në kontratën e shitblerjes së energjisë elektrike mes shoqërisë së ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik për blerjen e energjisë elektrike të prodhuar nga prodhuesit me përparësi, miratuar me vendimin e Bordit nr. 101, datë 23.6.2016, të ndryshuar,

konstatoi se:

- Me vendimin nr. 101, datë 23.6.2016, të Bordit të ERE-s, është miratuar kontrata për shitblerjen e energjisë elektrike ndërmjet OSHEE sh.a. dhe prodhuesve me përparësi të energjisë elektrike.
- Kjo vendimmarrje e ERE-s, në vijim, ka pësuar ndryshime e shtesa me vendimet e Bordit të ERE-s, me vendimin nr. 147, datë 30.9.2016, si dhe me vendimin nr. 255, datë 24.12.2018.
- Së fundmi Këshilli i Ministrave ka miratuar me VKM-në nr. 883, datë 27.12.2019, disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 244, datë 30.3.2016, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike", të ndryshuar.
- Konkretisht në nenin 11, pika 2, të VKM-së nr. 883, datë 27.12.2019, sipërcituar, është sanksionuar se: "2. Detyrimi i shërbimit publik për blerjen e energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme të energjisë i vendoset shoqërisë publike të furnizimit në tregun e lirë, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe kontratën tip, të miratuar nga ERE. Duke qenë se ndryshimet në kontratën tip vijnë si detyrim i VKM-së nr. 883, datë 27.12.2019, nuk nevojitet që t'i nënshtrohen një procedure konsultimi. Kontratat ekzistuese që OSHEE sh.a. ka me prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike do të transferohen te furnizuesi i tregut të lirë, bazuar në aktet e brendshme ligjore/administrative ndërmjet shoqërive.".

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Në kontratën e shitblerjes së energjisë elektrike mes shoqërisë së ngarkuar me detyrimin e shërbimit publik për blerjen e energjisë elektrike të prodhuar nga prodhuesit me përparësi, bëhen ndryshimet si vijon:

a) kudo në kontratë, OSHEE sh.a., në cilësinë e të ngarkuarit me detyrimin e shërbimit publik për blerjen e energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme të energjisë, do të zëvendësohet me shoqërinë publike të furnizimit në tregun e lirë FTL sh.a.;

b) në fund të pikës 1, të nenit 10, togfjalëshi: "të OSHEE sh.a.", bëhet me Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes OSSH sh.a.";

c) në fund pikës 3, të nenit 13, shtohet togfjalëshi: "me Operatorin e Sistemit të Shpërndarjes".

2. Për subjektet që kanë një kontratë të shitblerjes së energjisë elektrike me OSHEE sh.a. para apo në kohën e hyrjes në fuqi të këtij vendimi të ERE-s, kontrata për shitblerjen e energjisë elektrike me shoqërinë publike të furnizimit në tregun e lirë FTL sh.a., do të lidhet për periudhën e mbetur nga përfundimi i kontratës së lidhur me OSHEE sh.a.

3. Fuqia juridike e kontratës së ndryshuar me këtë vendim, lidhur mes FTL sh.a. dhe çdo prodhuesi me përparësi të energjisë elektrike për shitblerjen e energjisë elektrike, i shtrin efektet nga data e hyrjes në fuqi të këtyre ndryshimeve, deri në përfundimin e afatit të parashikuar në kontratat respektive të lidhura.

4. Të monitorohet, jo më vonë se 3 muaj nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, ecuria e procesit të transferimit të kontratave ekzistuese që OSHEE sh.a. ka me prodhuesit me përparësi të energjisë elektrike te Furnizuesi i Tregut të Lirë, FTL sh.a.

5. Drejtoria e Çështjeve Ligjore të njoftojë palët e interesit, për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti